



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i dokumentit: 22.0.1-2011-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË**  
**PRISHTINËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011**

**Prishtinë, Qershor 2012**



## TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave .....	4
Përmbledhje e përgjithshme .....	5
1 Hyrje.....	7
2 Opinioni i auditimit .....	9
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar .....	10
4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar .....	11
5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëria me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit.....	13
6 Menaxhimi Financiar .....	14
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake).....	14
6.2 Shpenzimet .....	17
6.3 Pasuritë .....	21
6.4 Borxhet dhe të Arkëtueshmet .....	21
6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor .....	22
7 Kontrolli mbi menaxhimin .....	23
7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	23
7.2 Auditimi i Brendshëm .....	24
8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Prishtinës .....	25
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	26
Shtojca II. Rekomandimet e vitit të kaluar .....	28

---

## Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik nr.03/L-241 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-042 në fuqi prej 05.10.2011
MF	Ministria e Financave
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
Rr F	Rregullat financiare të nxjerra nga Ministria e Financave
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë*

Ne do të donim t'ju tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

- Në shënimin 29, nuk është paraqitur asnjë vlerë tek detyrimet kontigjente. Nga ana tjetër, neve na është ofruar një dokument për kontestin gjyqësor që Komuna ka me fabrikën e amortizatorëve në Prishtinë, në vlerë prej 383,025€;
- Shënimi 30 dhe 31: Pasuritë jo-financiare me vlerë mbi dhe nën 1,000€, nuk janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë; dhe
- Në shënimin e 34, të arkëtueshmet nuk janë paraqitur në vlerën e saktë pasi janë prezantuar vetëm licencat e ndërtimit në shumën prej 8,495,000€ ndërsa të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë prej 31,593,516€ nuk janë prezantuar fare. Në lidhje me këtë të fundit, shpalosja duhet të ishte bërë bazuar në një analizë të plotë të asaj që konsiderohet ende e mundur për tu pranuar dhe çfarë duhet të konsiderohet për çregjistrim.

**(ISSAI 400: *Opinionit i pakualifikuar me theksim të çështjes*)**

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme në Komunën e Prishtinës nuk është dizajnuar në mënyrë të duhur për ti ofruar siguri të duhur menaxhmentit për procese administrative dhe financiare, e që nuk janë implementuar si duhet. Kjo do të duhej të adresohet për të përmirësuar performancën e organizatës.

Është i nevojshëm një dialog i gjerë me të gjithë menaxherët komunalë për të adresuar dobësitë e kontrollit dhe mangësitë menaxheriale. Këto duhet të diskutohen në detaje dhe të krijohet një pako masash për të përmirësuar performancën e përgjithshme administrative dhe financiare të administratës.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, në afatin sa më të shkurtër ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Që të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi të adresohen dhe të pasohen me masa adekuate të veprimit;
- Përmirësime të mëtutjeshme të performancës buxhetore;
- Harmonizimin dhe menaxhimin më të mirë të të hyrave vetjake;
- Se procedurat e prokurimit zhvillohen konform rregulloreve të prokurimit dhe të forcohen kontrollet e monitorimit të kontratave ;
- Shpalosjen e të gjitha llogarive të arkëtueshme;
- Shpalosjen e të gjitha obligimeve të komunës;
- Regjistrat e plotë për pasurinë e komunës; dhe
- Se një rishikim funksional i kontrolleve të brendshme do të bëhet dhe roli i auditimit të brendshëm do të fuqizohet më shumë.

Menaxhmenti i Komunës së Prishtinës i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona për vitin 2011 dhe i është zotuar që do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës të përgatisë PVF sipas kërkesave të Rregullës Financiare 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për Komunën e Prishtinës.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Prishtinës. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme, Pasqyrat Financiare nëntë mujore si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF të Prishtinës janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;

- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të Komunës së Prishtinës, SNISA përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën I.



---

## 2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë

Ne do të donim t'ju tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

- Në shënimin 29, nuk është paraqitur asnjë vlerë tek detyrimet kontingjente. Nga ana tjetër, neve na është ofruar një dokument për kontestin gjyqësor që Komuna ka me fabrikën e amortizatorëve në Prishtinë, në vlerë prej 383,025€;
- Shënimi 30 dhe 31: Pasuritë jo-financiare me vlerë mbi dhe nën 1,000€, nuk janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë; dhe
- Në shënimin e 34, të arkëtueshmet nuk janë paraqitur në vlerën e saktë pasi janë prezantuar vetëm licencat e ndërtimit në shumën prej 8,495,000€ ndërsa të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë prej 31,593,516€ nuk janë prezantuar fare. Në lidhje me këtë të fundit, shpalosja duhet të ishte bërë bazuar në një analizë të plotë të asaj që konsiderohet ende e mundur për tu pranuar dhe çfarë duhet të konsiderohet për çregjistrim.

*(ISSAI 400: Opinioni i pakualifikuar me theksim të çështjes)*

### 3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Në raportin tonë të auditimit të PVF të vitit 2010 janë dhënë 11 rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, 2 (dy) janë adresuar plotësisht, ndërsa 9 (nëntë) janë adresuar deri në një masë të caktuar. Për më tepër informata, shih shtojcën II.

Komuna e Prishtinës ka përgatitur një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime, aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në korrik të vitit 2011.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona të mëhershme, ka shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara.

## 4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

**Tabela 1: Shpenzimet buxhetore dhe burimet e fondeve në euro (€)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Pranimet/ Shpenzimet 2011	Pranimet/ Shpenzimet 2010
I. Gjithsej pranimet dhe transferi i donacioneve	59,487,719	76,180,900	74,601,391	64,072,671
Granti i Qeverisë - buxheti	39,311,797	39,564,797	39,313,857	32,721,713
Të bartura nga viti i kaluar	0	16,071,042	16,071,042	12,602,648
Të hyrat vetjake të vitit 2011	20,175,922	20,175,922	18,847,353 <sup>1</sup>	18,745,029
Donacionet e vendit	0	273,941	273,941	3,281
Donacionet e jashtme	0	95,198	95,198	0
II. Gjithsej shpenzimet	59,487,719	76,180,900	58,474,706	48,001,629
Paga dhe Mëditje	20,756,372	21,224,362	21,208,663	16,534,008
Mallra dhe shërbime	4,905,856	6,462,606	6,055,872	5,154,749
Shpenzimet komunale	2,116,674	1,966,674	1,935,228	2,100,660
Subvencionet dhe transferet	563,274	1,763,274	1,646,490	1,035,950
Investimet Kapitale	31,145,543	44,763,984	27,628,453	23,176,262
Rezervat	0	0	0	0
Diferenca I-II	0	0	16,126,685	16,071,042 <sup>2</sup>

Sipas të dhënave nga tabela më lartë, shihet se buxheti final për vitin 2011 për komunën e Prishtinës ka qenë 76,180,900€. Shpenzimet totale për vitin 2011 ishin 58,474,706€, apo rreth 77%. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, mos shpenzimi i buxhetit ka ndodhë për arsye të aprovimit me vonësë të buxhetit, mos fillimit të procedurave të tenderimit në kohën e planifikuar (ndarja e buxhetit për Komunën ka ndodhur më 27.04.2011) si dhe

<sup>1</sup> Të hyrat e mbledhura në 2011

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të bartura në 2011.

për shkak të vonesave në realizimin e punëve të kontraktuara. Sidoqoftë, Komuna e Prishtinës ka arritur të kontraktojë tërë shumën e buxhetit për vitin 2011.

Buxheti final ishte për 16,693,181€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo rritje ishte për shkak të grantit të qeverisë në vlerë prej 200,000€ që ishte dhënë për vërshimet dhe 53,000€ për paga dhe mëditje, të hyrave vetjake në vlerë prej 16,071,042€ dhe donacioneve 369,139€.

Diferenca prej 16,126,685€ është e hyrë vetjake e pashpenzuar në vlerë prej 15,978,842€ dhe donacionet e brendshme dhe të jashtme të pashpenzuara në vlerë 147,843€ të cilat barten për shfrytëzim në vitin 2012.

Tendenca e rritjes së shpenzimeve në fund të vitit buxhetor është më i dukshëm se më parë, pjesërisht për shkak të kushteve specifike buxhetore për vitin 2011. Vetëm në tre mujorin e fundit ishin shpenzuar rreth 46% e buxhetit.

### **Konkluzion**

Komuna nuk kishte arritur ta shpenzoj buxhetin ashtu siç kishte parashikuar dhe si rezultat kemi një tepriçë të buxhetit prej 23%. Po ashtu, dinamika e shpenzimeve nuk ishte planifikuar mirë në periudha kohore me rrjedhën e keshit, dhe 46% të shpenzimeve totale kishin ndodhur vetëm në tre muajt e fundit.

#### **Rekomandimi 1**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Forcimin e kontrolleve të përgjithshme financiare (administrative, buxhetore dhe menaxheriale) mbi menaxhimin e buxhetit;
- Se harmonizimet e duhura të alokimeve buxhetore bëhen në pajtim me planet e prokurimit, në veçanti me dinamikën e realizimit të projekteve kapitale; dhe
- Ecuritë buxhetore përcillen me analiza të kohëpaskohshme dhe në pajtim me gjendjen, merren veprimet e duhura.

## 5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëria me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Draft PVF të komunës të përgatitura më 31.01.2012 për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011 nuk ishin në pajtim me Rregullën Financiare nr. 07/2011. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta, prandaj ne gjatë procesit të auditimit i kemi sugjeruar menaxhmentit që Draft PVF të korrigjohen. Draft PVF të komunës, pas vërejtjeve tona, janë korrigjuar dhe dërguar për herë të dytë në Thesar. Mirëpo prapë disa gabime kanë mbetur të pa korrigjuara në PVF finale.

Mangësitë e PVF janë:

- Në shënimin 29, nuk është paraqitur asnjë vlerë tek detyrimet kontigjente. Nga ana tjetër, neve na është ofruar një dokument për kontestin gjyqësor që Komuna ka me fabrikën e amortizatorëve në Prishtinë, në vlerë prej 383,025€;
- Në shënimin 30 - Përmbledhja e pasurive jofinanciare- edhe pse është shpallur vlera prej 10,450,000€, kjo nuk është as e përafërt me vlerën reale, pasi që komuna nuk kishte mundur t'i vlerësoj ndërtesat, tokën dhe pajisjet;
- Në shënimin 31 pasuritë financiare nën 1,000€, nuk është prezantuar asnjë vlerë; dhe
- Në shënimin 34, të arkëtueshmet nuk ishin paraqitur në vlerën e saktë, sepse janë prezantuar vetëm lejet e ndërtimit në vlerë prej 8,495,000€, ndërsa të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 31,593,516€ nuk ishin prezantuar. Këto shuma janë të grumbulluara nga viti 2002 -2011. Në lidhje me këtë të fundit, shpallorja duhet të ishte bërë bazuar në një analizë të plotë të asaj që konsiderohet ende e mundur për të pranuar dhe çfarë duhet të konsiderohet për çregjistrim.

Kërkesat e LMFP nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare nr. 07/2011.

- PVF janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- PVF janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 29/01/2012, ndërsa më pas janë korrigjuar dhe më 24.02.2012 janë dërguar në MF; dhe
- PVF janë përgatit në gjuhën shqipe dhe serbe.

### **Konkluzioni**

Mungesa e shpallorjes së informatave në PVF bën që këto pasqyra të jenë jo të plota dhe të mos ofrojnë pasqyrën reale mbi pasuritë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet e

komunës. Kontrolli mbi të gjitha pasuritë do të mund të bëhet më i mirë duke i regjistruar dhe përcjellë të gjitha ato në mënyrë të organizuar.

### **Rekomandimi 2**

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:

- Se përgatitja e PVF do të bëhet në pajtim të plotë me kërkesat ligjore, duke përfshirë të gjitha shpalosjet e kërkuara.

## 6 Menaxhimi Financiar

### 6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të hyrat vetjake të planifikuara ishin 20,175,922€ kurse gjatë periudhës janar-dhjetor janë inkasuar 18,847,353€. Ne kemi bërë ekzaminime mbi zbatimin e procedurave për regjistrim dhe mbledhjen e të hyrave, dhe kemi identifikuar si më poshtë:

#### *Mosbarazimi i të hyrave në mes të thesarit dhe departamentit të tatimit në pronë në MF*

Gjatë krahasimit të pagesave të tatimit në pronë kemi vërejtur se harmonizimet midis komunës dhe thesarit nuk janë bërë si duhet. Sipas bazës së të dhënave në MF, departamenti i pronës këto të hyra i kishte regjistruar në 3,824,092€, ndërsa sipas të dhënave të Thesarit (të prodhuar paksa me vonesë) ishin 3,844,124€. Pra një mosbarazim prej 20,032€.

#### *Tatimi në pronë*

Kemi bërë testimin e 41 mostrave, nga të cilat rezulton se 16 obligues të tatimit në pronë kanë borxhe të pa paguara në vlerë prej 41,277€.

Obliguesve të tatimit në pronë iu janë lëshuar vërtetime që nuk kanë obligime tatimore ndaj komunës. Komuna është dashur ti gjenerojë ato në mënyrë manuale për shkak të faktit se softueri qendror i menaxhuar nga Departamenti i pronave në kuadër të MF-së nuk ishte në gjendje të ofrojë këtë shërbim gjatë pjesës më të madhe të vitit. Kjo situatë po ashtu ka rezultuar edhe në gabime në lidhje me informatat themelore të prezantuara. Kjo praktikë është ndërprerë. Që nga dhjetori 2011, softueri i tatimit në pronë është avancuar duke lejuar që çertifikatat mbi tatimin në pronë të gjenerohen automatikisht dhe në mënyrë manuale.

Taksa nga leje ndërtimi

Kemi bërë testimet e 59 (pesëdhjetë e nëntë) mostrave të transaksioneve të lejeve të ndërtimit në vlerë të përgjithshme prej 7,432,468€ dhe kemi gjetur se:

Aktvendimi nr. 05-351-40763 i dt. 24.01.2011 në shumë prej 660,025€, ishte paraparë që pagesat të bëhen në katër këste. Kësti i parë ishte paguar në shumë prej 198,007€, kurse për këstet tjera të mbetur për tu paguar në shumë prej 462,017€, janë siguruar garancione bankare duke filluar nga 03.06.2011 deri më 01.06.2013. Ne kemi vërejtur se garancioni bankar nuk është aktivizuar. Komuna ka dërguar një letër Bankës Qendrore të Kosovës dhe ka informuar atë se bankat komerciale nuk po i përmbushin obligimet e tyre. Në të njëjtën kohë, është e qartë se Komuna duhet të bëjë përcjelljen në kohën më të përshtatshme për të.

Borxhet e pa arkëtuara nga lejet e ndërtimit si pasojë e skadimit të afatit të vlefshmërisë të garancioneve nga bankat apo kompanive të sigurimeve

Gjatë rishikimit të listave të borxheve të papaguara nga taksat për leje të ndërtimit, kemi identifikuar se komuna nuk i kishte ekzekutuar garancionet e siguruar që obliguesit i kishin bërë për borxhet që kishin ndaj komunës. Komuna kishte kërkuar nga Banka Qendrore e Kosovës të përdorte autoritetin e saj mbikëqyrës ndaj bankave dhe të sigurojë që këto garancione të ekzekutohen. Një numër i garancioneve më nuk ishin valide. Borxhet e pa arkëtuara nga viti 2008 deri me 2011 ishin në vlerë prej 4,988,920€. Është e rëndësishme që Komuna të forcojë përcjelljen e borxheve të pa paguara duke reduktuar rrezikun për humbje.

Taksa e regjistrimit të automjeteve dhe të hyrat nga shërbimet kadastrale

Gjatë rishikimit të pagesave të taksave për regjistrimin e automjeteve dhe të hyrat nga shërbimet kadastrale, është vërejtur se janë bërë pagesa në arkë mbi 10€. Kjo praktikë është në kundërshtim me nenin 11 të rregullës financiare 03/2010 për të hyrat, ku çdo pagesë mbi 10€ duhet të kryhet përmes bankës. Komuna ka ndërprerë këtë praktikë që nga nëntori i vitit 2011.

Të hyrat nga dhënia me qira të pronës publike

Kuvendi Komunal merr të gjitha vendimet për dhënien e pronës publike me qira. Nga 29 shfrytëzues të pronës publike, kemi bërë testimin e shtatë (7) mostrave më një ngarkesë vjetore prej 26,242€. Prej tyre, borxhin e kanë paguar 28% apo vetëm 7,318€. Kemi vërejtur se veprime të nevojshme nuk janë dizajnuar plotësisht nga ana e Komunës për të siguruar të hyrat në rastet kur përdoruesit nuk e paguajnë qiranë.

*Të hyrat nga dhënien me qira e tokës për nevoja të ndërmarrjes "Tregu" NSH Prishtinë*

Marrëveshja për nën-qiradhënie nr. 217 të dt. 10/05/2005 në mes të Komunës së Prishtinës dhe NSH "Tregu" parasheh që Komuna e Prishtinës tokën prej 6.42.5 hektarë (tokë e marrë me qira nga ndërmarrja "Amortizatori") dhe tokën prej 4.76.78 hektarë pronë komunale i jep me qira Ndërmarrjes "Tregu" për ta shfrytëzuar për tri (3) vite, nga dt. 10/05/2005 deri më 09/05/2008. Qiramarrësi (Tregu) është i obliguar t'i paguaj Qiradhënësit (Komunës) për tokën e marrë me qira shumën prej 32,140€ për çdo muaj kalendarik (paragrafi 3.1 i marrëveshjes). Ne, gjatë auditimit, nuk kemi gjetur dëshmi se këto pagesa mujore janë bërë nga ndërmarrja "Tregu" apo janë paraqitur nga komuna si borxhe të pa mbledhura në PVF të vitit 2011.

Gjatë rishikimit të dokumentacionit, kemi vërejtur se Komuna bazuar në vendime gjyqësore është dashur ti paguajë kompanisë "Amortizatori" shumën prej 635,850€ për shkak të obligimeve të dakorduara më herët. Ne duhet ta marrim si të mirëqenë që Komuna ka nxjerrë përvoja nga këto lloje të veprimtarive me paratë e taksapaguesve, duke mos përsëritur gabimet.

*Te hyrat nga participimi për qëndrimin ditor të fëmijëve në çerdhe*

Gjatë testimit të shtatë mostrave dhe testimit të kontrolleve të regjistrave, kemi vërejtur se ka raste të pagesave me vonesë për fëmijët në çerdhe dhe rastet kur nuk janë bërë pagesat.

**Konkluzioni**

Gjetjet e identifikuar më lart, flasin për një sërë dobësish të kontrolleve mbi të hyrat. Komuna ka ndërmarrë masa tjera për tu siguruar që taksa paguesi i cili ka detyrime të mos ketë shërbime para se kjo situatë të rregullohet. Megjithatë, proceset e mira dhe kontrollet në burim për shërbime janë komponentë e padiskutueshme për menaxhim të mirë financiar.



**Rekomandimi 3**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Harmonizimet e duhura të të hyrave vetjake në mes të zyrtarit të të hyrave dhe drejtorive;
- Është instaluar përcjellje më e mirë e garancioneve duke siguruar pagesat para se t'i skadojë afati i vlefshmërisë; dhe
- Qe të ndërmer masa të nevojshme ligjore për të inkasuar borxhet nga dhënia e tokës më qira dhe pronës tjetër publike.

## 6.2 Shpenzimet

### 6.2.1 Prokurimi

Vlera e kontratave të nënshkruara ishte 37,636,517€, ndërsa ne kemi testuar 25 nga 218 raste, që mbulojnë prokurim në vlerën 21,650,000€ apo 57% të totalit. Ne kemi vërejtur se në disa raste Komuna nuk ka mundur ti menaxhojë si duhet punët e kontraktuara. Këto raste nuk ishin në mënyrë ekonomike ose nuk i kanë ndjekur plotësisht procedurat e duhura dhe parimet e Menaxhimit të Financave Publike dhe kontrollit dhe të Prokurimit.

#### Pagesat e bëra për punët e pakryera

Komuna kishte lidhur kontratë me datën 29.07.2010 për "Ndërtimi i objektit të bibliotekës së qytetit" në vlerë prej 1,502,443€. Sipas planit dinamik, ky projekt është dashtë të përfundoj brenda 190 ditësh. Sipas raportit të organit mbikëqyrës, më 28.09.2011, 90% e punëve ishin kryer dhe aprovuar. Totali i pagesave të bëra më pas për këtë kontratë është 1,323,917€ ose 88%. Në një ekzaminim në vendin e punës më 29.02.2012, ekipi ynë ka identifikuar se puna e bazuar në kontratë është kompletuar me një vonesë shumë të madhe. Autoriteti kontraktues është njoftuar për këtë rast. Në një ri-ekzaminim të vendit të punës nga ekipi ynë së bashku me organin mbikëqyrës në fund të majit 2012, ne arritëm në përfundimin se niveli i punës ishte në pajtim me nivelin e pagesës. Me këtë rast lidhet edhe një kontratë që Komuna kishte lidhur më 27.12.2011. Kjo kontratë ishte lidhur për "Punimet përfundimtare në objektin e bibliotekës së qytetit" në vlerë prej 155,101€. Komuna kishte lidhur një kontratë të dytë me kompani tjetër për shkak të keq kalkulimeve në lidhje me punët e kontraktuara në kontratën e parë për bibliotekën e qytetit. Pas diskutimeve tona me autoritetin komunal për të qartësuar fillimisht vonesat në përfundimin e punës në këtë projekt, kjo kontratë më pas u anulua deri në finalizimin e kontratës së parë.

Po ashtu, kontrata që ka të bëjë me "Ndërtimin e objektit të shkollës ekonomike" në vlerë prej 1,399,486€ është nënshkruar me datë 22.07.2011. Edhe në këtë rast janë bërë pagesa për punë që nuk ishin përfunduar ende. Sipas organit mbikëqyrës punët e kryera dhe të aprovuara ishin mbi 50% deri më 23.12.2011. Pagesat e bëra për këtë kontratë ishin 687,916€ ose 49%. Më 29.02.2012, ne kemi bërë një ekzaminim fizik të objektit së bashku me organin mbikëqyrës të komunës dhe konstatuam se komuna kishte paguar 25,925€ për punë të papërfunduara. Në të dyja këto raste organet e ndryshme mbikëqyrëse janë pajtuar me gjendjen e përshkruar dhe firmosëm një dokument me secilin prej tyre në lidhje me situatën reale.

Edhe në këtë rast është bërë një ri-ekzaminim më 29.05.2012. Me këtë rast kemi vërejtur se për mbi pagesën prej 25,925€ punimet ishin kryer.

Pas diskutimeve tona me komunën rreth dy rasteve, Komuna mori një vendim përmes të cilit i urdhëron të gjithë organet mbikëqyrëse të të gjithë projekteve që në mënyrë strikte t'i bëjnë të gjitha pagesat në pajtim me kontratën.

#### Pagesa të bëra sipas furnizimit të materialeve, e jo sipas punëve të kryera

Kontrata për "Sanimi i rrafshit rrëshqitës në lagjen Arbëria" në vlerë prej 696,258€ ishte nënshkruar me datën 05.10.2011. Sipas kësaj kontrate, kompania kontraktuese duhej ta bënte stabilizimin e terrenit në rrugën "Ekrem Rexha". Kjo duhet të bëhet brenda 30 ditëve sipas planit dinamik. Kontrata duhet të paguhet në pjesë. Pjesa e parë do të paguhet 200,000€ pas kryerjes së furnizimeve të parapara me kontratë, dhe konfirmimit nga menaxheri i projektit. Pjesa e dytë dhe tretë duhej të paguhet pasi menaxheri i projektit i komunës konfirmon se punimet janë kryer. Sipas kontratës, pagesa e parë bëhet në bazë të furnizimit, por ne patë vështirësi t'i krahasonim faturat e furnizimeve të bëra nga kompania. Këto nuk mund të identifikoheshin në paramasën dhe parallogarinë e bërë nga komuna. Deri me datën 14.11.2011, për këtë projekt ishin paguar 500,000€. Pavarësisht këtyre mangësive, projekti megjithatë u përfundua sipas kontratës.

#### Menaxhimi jo i kënaqshëm i derivateve të naftës për ngrohje për institucionet shkollore

Ne kemi testuar shpenzimet e derivateve për ngrohje në vlerë prej 392,968€. Zyrtarët të cilët merren me menaxhimin e ngrohjeve, nuk mbajnë evidenca mbi sasinë e pranuar dhe të shpenzuar të derivateve. Po ashtu, kemi vërejtur se nuk ekzistojnë instrumente të matjes së shpenzimeve të naftës për ngrohje. Përveç kësaj, Sigurimi i qasjes tek rezervuarët nuk ishte në nivel të kënaqshëm.

### **Konkluzioni**

Mënyra se si Komuna ka trajtuar paratë e taksapaguesve në rastet e sipërpërmendura lë hapësirë për përmirësim. Ky është një tregues i qartë që komuna duhet të kryejë analiza më të thella në lidhje me cilësinë e menaxhimit të projektit dhe mbikëqyrjes së

implementimit të projektit. Pagesat në avance faktikisht është të vepruarit si një bankë për partnerët në kontratë. Kjo, nuk është në pajtim me praktikat e mira për trajtimin e mjeteve buxhetore.

Menaxhimi jo i kënaqshëm me derivatet e naftës për ngrohjen e shkollave nuk ofron siguri të mjaftueshme se shkollat janë furnizuar në sasinë e nevojshme dhe në kohën e duhur, duke marrë parasysh se mungojnë raportet ditore ose javore për sasinë e shpenzuar.

Marrë të gjitha parasysh, kjo tregon se procesi i prokurimit në përgjithësi, dhe proceset e zbatimit të kontratës në veçanti, duhet të zhvillohen. Linjat e llogaridhënies duhet të krijohen dhe kontrollet e menaxhmentit mbi proceset duhet të forcohen.

#### **Rekomandimi 4**

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që fillojë me masa të menjëhershme në forcimin e proceseve të prokurimit dhe mbikëqyrjes. Për ta bërë këtë, Kryetari i Komunës rekomandohet veçanërisht që të sigurojë se:

- Se asnjë pagesë nuk do të bëhet për para se punimet të përfundohen;
- Se pagesat për kontratat ndërtimore do të bëhen në pajtim me shkallën e përmbushjes së punimeve; dhe
- Shtimin e kontrolleve në menaxhimin e derivateve.

Përveç kësaj ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të fillojë të bëjë një analizë të detajuar të rasteve ku dyshohet për keq menaxhim dhe për këtë të marrë masat përkatëse. Më tutje, ne mendojmë se është e rëndësishme që të fillohet me një auditim të brendshëm specifik, i cili do të fokusohet në efektivitetin e prokurimeve të përgjithshme me vlera të mëdha në komunë.

## 6.2.2 Blerjet tjera

### Pagesat e bëra me profatura

Gjatë ekzaminimit të lëndës "Shpenzimet për ngrohje" kemi vërejtur se komuna i kishte paguar 40,924€ vetëm në bazë të profaturave kompanisë "Termokos" në emër të shpenzimeve të ngrohjes para se të pranoj shërbimet e ngrohjes. Me përjashtim të vlerës 2,725€, deri në datën e auditimit këto shpenzime nuk ishin arsyetuar me fatura. Po ashtu, te kjo lëndë kemi vërejtur se komuna kishte paguar tre deri në katër herë profaturat e njëjta në një vlerë prej 19,784€. Komuna ka harmonizuar pagesat në Mars të vitit 2012 bazuar në profatura dhe shpenzime reale të nxehjes sipas faturave.

Keni parasysh se Termokosi si kompani publike komunale është nën menaxhim të Komunës.

### **Konkluzioni**

Pagesat e bëra me profatura para se të kryhet shërbimi, krijon vështirësi në kuptim të menaxhimit të duhur të shpenzimeve nga ana e Komunës. Ekzistimi i një marrëdhënieje të drejtë dhe të shëndoshë afariste midis administratës komunale dhe ofruesve të shërbimeve në formën e ndërmarrjeve është e një rëndësie të madhe.

#### **Rekomandimi 5**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se të gjitha shpenzimet e ndodhura do të arsyetohen me fatura dhe kjo praktikë duhet të mos përsëritet.

### **6.2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)**

Gjatë vitit 2011 buxheti për kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje ishte 21,224,362€, kurse ishin shpenzuar shuma prej 21,208,663€. Kemi testuar 22 mostra.

Në një rast kemi vërejtur se zyrtares që kishte shkuar në pushim të lehonisë i është paguar paga e plotë deri në fund të vitit 2011.

### **Konkluzioni**

Pagesa e plotë e pagës për zyrtaret që janë në pushime të lehonisë, nuk është në pajtim me ligjin dhe ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës.

#### **Rekomandimi 6**

Rekomandojmë Kryetarin Komunës që të siguroj:

- Që të shtohen kontrollet mbi pagesën e pagave dhe njëherit shumat e paguara më tepër, t'i kthehen buxhetit të Kosovës.

### **6.2.4 Subvencionet dhe transferet**

Buxheti për subvencione dhe transfere për vitin 2011 ishte 1,763,274€, ndërsa shpenzimet ishin 1,646,490€.

Me rastin e testimit të 17 mostrave në vlerë prej 848,802€, ne nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi të rëndësishme.

## 6.3 Pasuritë

### 6.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Komuna e Prishtinës posedon një regjistër të pasurisë, mirëpo ky regjistër nuk është i plotë dhe i saktë. Komuna ende nuk ka arritur t'i përfshij ndërtesat që shfrytëzohen nga bashkësitë lokale, objektet shëndetësore, arsimore dhe pasurinë tjetër në këtë regjistër, për shkak se nuk ishte në gjendje t'i vlerësoj ato. Po ashtu, vlera e tokës prej 540,000€ e prezantuar në PVF nuk është e saktë.

#### **Konkluzioni**

Edhe përkundër përpjekjeve të Komunës që të regjistroj të gjitha pasuritë me të cilat disponon, nuk është arritur ende që kjo punë të kompletohet. Prandaj, mbetet edhe më tutje kërkesë që të përfshihen të gjitha pasuritë në pronësinë komunale në një regjistër, ku do të përshkruhej edhe vlera edhe sasia e tyre.

#### **Rekomandimi 7**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Vlerësimin e plotë të pronës, objekteve dhe pajisjeve, në mënyrë që të ketë regjistrin përfundimtar për të gjitha pasuritë që ka nën posedim; dhe
- Të bëj ruajtjen, shfrytëzimin dhe mbajtjen nën kontroll të pronës publike.

## 6.4 Borxhet dhe të Arkëtueshmet

### 6.4.1 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte 71,000€. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2012. Kjo çështje është adresuar më herët në raport.

#### **Konkluzioni**

Për hir të planifikimit të duhur të shpenzimeve është e rëndësishme së veçantë që borxhet dhe borxhet potenciale të mbahen nën kontroll strikte gjatë vitit aktual.

**Rekomandimi 8**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta dhe bën regjistrimin e të gjitha faturave të paguara; dhe
- Bën vlerësimin dhe shpalosjen e të gjitha detyrimeve kontingjente.

**6.4.2 Trajtimi i të Arkëtueshmeve**

Komuna nuk kishte evidenca të sakta mbi llogaritë e arkëtueshme dhe si rezultat i saj nuk kishte bërë barazimet e duhura. Kështu, llogaritë e arkëtueshme sipas regjistrave të lejeve të ndërtimit ishin 4,955,706€, ndërsa në PVF ishin prezantuar 8,495,000€. Po ashtu, të arkëtueshmet nga tatimi në pronë sipas regjistrave kontabël ishin 31,593,516€, ndërsa në PVF nuk janë prezantuar fare.

Këto shuma janë të grumbulluara nga viti 2002 -2011. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit 30% të arkëtueshmëve i takojnë obligimeve të NSH-ve nën proces të privatizimit, rreth 30% janë interes dhe ndëshkime për tatimin në pronë dhe pjesa tjetër ka të bëjë me borxhet e pa mbledhura.

**Konkluzioni**

Regjistrat për llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvillohen në atë mënyrë që të specifikojnë qartë karakterin, afatin, dhe nëse janë të dyshimta ose të këqija. Kjo do të kontribuonte në planifikim buxhetor.

**Rekomandimi 9**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Mbajtjen dhe azhurnimin e regjistrave të plotë për llogaritë e arkëtueshme, si dhe shpalosjen e tyre në PVF.

**6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor**

Komuna kishte përgatitur raportet tremujore, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë. Po ashtu, draft plani i prokurimit ishte dërguar me kohë.

Komuna kishte përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve për vitin 2010.

## 7 Kontrolli mbi menaxhimin

### 7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Ne kemi vërejtur se kontrollet dhe proceset e përgjithshme në praktikë ende nuk funksionojnë si duhet. Nivelet aktuale të kontrolleve nuk ofrojnë siguri se aktivitetet financiare dhe administrative janë kryer në pajtim me objektivat e vendosura dhe procedurat e përcaktuara.

Fushat kryesore të mangësive janë regjistrimi, barazimi i të hyrave dhe mbledhja e tyre, përcjellja e marrëveshjeve, ekzekutimi i projekteve kapitale dhe pagesat që lidhen me këto projekte si dhe çertifikimi i pagesave. Monitorimi i kontratave dhe çertifikimin jo i rregullt i pagesave mbeten dy çështje kryesore që duhet të adresohen nga menaxhmenti.

Një problem tjetër është regjistrimi i pasurisë, që le hapësirë për përmirësim. Komuna ka shumë prona të cilat nuk ka arritur ti regjistroj dhe kjo pasohet nga mangësitë në menaxhim.

#### **Konkluzioni**

Pavarësisht veprimeve të ndërmarra deri më tani nga menaxhmenti i Komunës, konsiderojmë se duhet të ndërmerren masa të theksuara për të ndërtuar një ambient më të fuqishëm të kontrollit duke përfshirë objektiva shumë të qarta të cilat duhet të arrihen, raportim të brendshëm më i mirë në përgjithësi dhe përcjellje e mjaftueshme duke siguruar procese të implementuara ashtu si janë paraparë dhe masa të merren në rastet e nën-performancës dhe keq menaxhimit. Kjo kulturë gjerësisht duhet të jetë pjesë e administratës.

#### **Rekomandimi 10**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se do të ndërmerren masa të menjëhershme dhe të qarta për adresimin e të gjitha mangësive të kontrollit të brendshëm, duke nxjerrë udhëzime dhe procedura të qarta në zbatimin rigoroz të kontrolleve aktuale si dhe vendosjen e kontrolleve; dhe
- Janë marrë masa në ngritjen e vetëdijes tek i gjithë stafi përkatës për qasjet, pritjet dhe kërkesat e mjedisit të kontrollit të brendshëm.

## 7.2 Auditimi i Brendshëm

NJAB (Njësia e Auditimit të Brendshëm) në Komunën e Prishtinës funksionon me tre auditorë, disponon planin strategjik dhe vjetor të auditimit. Gjatë vitit 2011, kjo njësi kishte kryer tre, nga tetë raporte sa i kishte planifikuar.

Auditimi i brendshëm kishte dështuar të realizoj planin vjetor të auditimit. Gjatë vitit 2011, kishte arritur që t'i kryej vetëm tri raporte, të cilat mbulonin vitin 2010 dhe asnjë aktivitetet për vitin 2011. Raportet të cilat janë kryer nga NJAB kishin si objektivë të hyrat në drejtorinë e Arsimit viti 2009, të hyrat nga drejtoria e kadastrit për vitin 2010 dhe njësia e transportit. Fokusi i planit dhe cilësia e raporteve lë hapësirë për përmirësime.

Komiteti ka mbajtur gjithsej dy takime dhe ka shqyrtuar raportet dhe planin e punës së NJAB për vitin 2011, dhe njëherit raportin e Auditorit të përgjithshëm për vitin 2010.

### Konkluzioni

Auditimi i brendshëm në komunë është jo efikas dhe nuk i shërben qëllimit në kohën e duhur. Pjesërisht për shkak të kësaj, bashkëpunimi me menaxhmentin nuk është duke funksionuar ashtu si duhet. Menaxhmenti i komunës duhet të jetë i qartë në të shprehurit e pritjeve së tij dhe ti ofroj pikëpamjet e qarta për nevojat e tyre. Ekziston nevoja për një koordinim shumë më të mirë dhe rol më aktiv të auditimit të brendshëm në dhënien e sigurisë për cilësinë e kontroleve të brendshme në fushat me rreziqet më të mëdha. Dhënia e këshillave se si të përmirësohen sistemet e kontrollit të brendshëm duhet të jetë fokusi kryesor.

### Rekomandimi 11

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj se:

- Sistemi i auditimit të brendshëm në komunë (NJAB dhe AK) janë ngritur duke përfshirë një marrëdhënie të re dhe koordinim më të mirë në mes të menaxhimit dhe sistemit. Identifikimi i zonave me rreziqet më të mëdha të biznesit është një fushë ku duhet të kontribuojnë të gjithë partnerët në këtë sistem. Duke bërë këtë, prioritet duhet t'i jepet aktiviteteve aktuale, dhe jo proceseve nga vitet e mëparshme.



## 8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Prishtinës

### Konkluzionet e përgjithshme

Komuna ende ka nevojë të përmirësojë strukturën e qeverisjes. Menaxhmenti i komunës duhet të fokusohet më shumë në ndërtimin e një mjedisi modern të kontrollit të brendshëm duke siguruar përqendrim në rezultate dhe vlerë për taksapaguesit. Mungesa e një fokusi në trajtimin e çështjeve të ngritura nga auditimi i jashtëm rezultojnë në përsëritjen e mangësive të ngjashme si vitet e mëparshme. Komuna duhet të bëjë përmirësime të mëdha dhe analiza më gjithëpërfshirëse në rast të planifikimit dhe realizimit të buxhetit. Duhet të bëhet një planifikim më i mirë në përcaktimin e dinamikës së projekteve kapitale. Aktivitetet e prokurimit duhet të planifikohen saktë dhe të fillohen sa më herët në mënyrë që të arrihet përmbushja e kontratave sa më mirë.

Analiza strategjike duhet të bëhen për të hyrat vetjake. Bartja e të hyrave prej 16 milionë euro është pasojë e vonesave në përzgjedhjen e projekteve dhe ndjekjen e procedurave të duhura. Gjendja e tanishme e të arkëtueshmeve tregon se duke forcuar masat e kontrollit komuna mund të sigurojë më shumë të hyra.

Menaxhmenti i komunës duhet të rishikoj aftësitë dhe kompetencat e stafit. Aftësitë e stafit dhe përvoja e tyre duhet të jenë pikënisje për ndarjen e detyrave dhe dhënien e përgjegjësive. Stafi i menaxhmentit të mesëm dhe të tjerët duhet vlerësuar nëse e kuptojnë mjaftueshëm kornizën e KBFP. Nëse këto njohuri mungojnë, duhet organizuar trajnime për t'u bërë të qartë të gjithëve kërkesat e dokumenteve bazike ligjore. Sqarimi i procedurave të MF/K do të ishte një kontribut i madh në këtë drejtim.

Forcimi i masave të përgjegjësive dhe llogaridhënies duhet të jenë objektiva të përhershme të menaxhmentit. Ato duhet të shtrihen gjerësisht në tërë administratën.

### Rekomandimi i përgjithshëm

Rekomandojmë Kryetarin e komunës:

- Të zhvilloj një dialog të gjërë me të gjithë menaxherët e komunës, të diskutoj në hollësi të gjitha dobësitë e kontroleve dhe mangësitë menaxheriale dhe të propozoj një pako masash për të përmirësuar performancën e përgjithshme administrative dhe financiare të administratës.

## Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

---

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;

b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinionin në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca II. Rekomandimet e vitit të kaluar

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
4. Analiza e Shpenzimeve në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar.	Shpenzimi i mjeteve të bëhet në harmoni me planin e rrjedhës së parasë.		X	
5.1. Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	Se me rastin e përgatitjes së PVF, të përfillen të gjitha kërkesat që dalin nga UA.		X	
5.2. Cilësia e informatave	Të analizoj arsyet se përse pasqyrat financiare përmbajnë gabime.		X	
6.1. Të hyrat	Rritja e inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë; <ul style="list-style-type: none"> <li>• Se barazimet e të hyrave në mes drejtorive, financave dhe Thesarit.</li> </ul>		X	
6.2.1 Blerjet përmes prokurimit	Procedurat e prokurimit të jenë në pajtim me LPP.		X	
6.2.2 Blerjet tjera	Shtimi i kontrollit me rastin e pagesave në mënyrë që të mos përsëriten pagesa të dyfishta; dhe <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpalosjen e të gjitha detyrimeve kontingjente në P/F.</li> </ul>		X	

6.2.3Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Pagesat të bëhen në kodet përkatëse.	X		
6.3.1Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Regjistrimin e pronës, objekteve dhe pajisjeve, në mënyrë të duhur.		X	
6.3.2. Borxhet	Departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta dhe bën regjistrimin e të gjitha faturave të pranuar.	X		
7.1. Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	Të adresohen të gjitha rekomandimet e auditimit; dhe • Se sistemi i kontrollit të brendshëm do të rishikohet dhe të propozohen masat e duhura.		X	
7.2 Auditimi i Brendshëm	NJAB do të angazhohet në përmbushjen e planit të auditimit në tërësi; dhe Do t'i identifikoj fushat me rrezik të lartë dhe të fokusohet në aktivitetet e vitit aktual.		X	
Totali	11	2	9	0